



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 4838/prot.

Tiranë, më 12.1.2024

Lënda: Kthim përgjigjeje kërkesës suaj për informacion të datës 28.12.2023

ZNJ. J C.

E nderuar znj. C ,

Në përgjigje të kërkesës juaj për informacion, dërguar në datë 28.12.2023 tek koordinatoresha për të drejtën e informimit dhe protokolluar pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 4838 prot., datë 28.12.2023, ju informojmë se:

Bazuar në nenin 4, pika 5 dhe 7 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjetjet e hetimit administrativ, janë akte të brendshme të cilat i vihen në dispozicion vetëm palëve në këtë proces. Komisioni e ka bërë publik vendimin e arsyetuar me shkrim në faqen zyrtare të internetit, kpk.al, duke përmbushur kështu detyrimin ligjor për informimin e publikut, në respektim të parimeve mbi të cilat kryhet ky proces nga organet e rivlerësimit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Edmond Murçani

